



Prishtinë: 29.03.2018

Kodi i ZRRE-së: V_950_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1592_07_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **18.07.2017**.

në seancën e mbajtur më datë **29.03.2018**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin F.H., nga Prishtina, me shifër të konsumatorit **DPR - 3706** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1592_07_17 i datës 07.07.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.07.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimi i datës 28.12.2016 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi, por vetëm një pjesë ndërsa pjesa e mbetur e energjisë e pa regjistruar përmirësohet përmes korrigjimit të faturave për 6 muajt e fundit të faturimit të njehsorit nr.2881028. Në ankesë theksohet se pasaktësia në matje nuk është trajtuar si shfrytëzim i paautorizuar nga KESCO. KESCO gjithashtu thekson se ZRRE vendimin e saj e mbështet në rrjedhën e energjisë elektrike aktive vetëm për periudha të caktuara dhe se nuk ka marrë për bazë muajin kur është ndërruar njehsori ku vetëm për 12 ditë është shpenzuar 217 kWh ndërsa në muajin paraparak 10/2016 për 30 ditë janë shpenzuar 146 kWh e që tregon se njehsori nuk ka bërë matje të saktë.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE _V_1592_07_17, në lidhje me shifrën DPR - 3706 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.



Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se korrigjimi i datës 04.06.2015 është në përputhshmëri me dispozita ligjore të rregullave në fuqi, për Bordin pretendimet të tilla janë vlerësuar si të paqëndrueshme për faktin se nga analiza e bërë rrjedhës së energjisë elektrike konsumatori nuk ka dallim të madh të shpenzimit mes njehsorit të vjetër dhe njehsorit të ri elektrik.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalet e inspektimit dhe rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe se gjatë analizimit të gjendjes së shpenzimit është vërejtur se kemi mospërputhje të shpenzimeve të njehsorit elektrik nr.2881028 në mes të gjendjes së shpenzimit të evidentuar në procesverbal dhe atë të evidentuar në rrjedhën e shpenzimit të energjisë aktive dhe se kemi mbi faturim prej 202 kWh më shumë të faturuara.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka analizuar edhe listat e leximit të KEDS-it prej periudhës 06/2014 deri më 10/2014 dhe prej periudhës 09/2016 e deri më 01/2017, dhe nga analiza e bërë listave të leximit është vërejtur se në periudhat 06/2014, 07/2014 nuk përputhen me të dhënat e evidentuara në rrjedhën e energjisë elektrike aktive, pasi në rrjedhën e energjisë elektrike aktive ka më shumë kWh të faturuar se sa në njehsor elektrik, e që kjo tregon se ka mosputhje të gjendjes së shpenzimit mes listave të leximit dhe atyre të faturuara.

Bordi i ZRRE ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit dhe se sipas rrjedhës së energjisë elektrike vërehet nga periudha 08/2016 e deri më 11/2016 ka pasur shpenzim të faturuar me njehsorin elektrik nr.2881028 dhe se nga analiza rezulton se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për këtë periudhë është 256 kWh/muaj, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin elektrik të ri nr.67264373 prej periudhës 11/2016 e deri më 05/2017 është 313 kWh/muaj. Nga kjo shihet qartë se nuk ka dallim të madh të shpenzimit mes njehsorit të vjetër dhe njehsorit të ri elektrik.

Bordi i ZRRE në pikën e kundërshtimit se ngarkesa shtesë është bërë për shkak se konsumatori nuk i është regjistruar e tërë energjia por vetëm njëra pjesë e saj dhe se ky korrigjim është në përputhshmëri me rregullat në fuqi. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së nga analizat e bërë shpresave të lëndës e posaçërisht ngarkesës shtesë të datës 28.12.2016 prej 84.53€, ku konsumatori është ngarkuar me ngarkesë shtesë për shkak matjes jo të saktë, është vërejtur se KESCO në përgjigjen e tyre dhënë konsumatorit nuk është bazuar në ndonjë dokument zyrtar e cila do ta vërtetonte se kemi të bëjmë me matje jo të saktë. Bordi i ZRRE-së konstaton se sipas Kodit të Matjes, në rastet e konstatimit të matjes jo të saktë bërë nga Qendra e Kalibrimit përmes shqyrtimit të saktësisë së njehsorit elektrik, atëherë varësisht nga saktësia e njehsorit elektrik, konsumatorit i ngarkohen apo i zbriten faturat për atë përqindje të konstatimit. Mirëpo te rasti i konsumatorit KEDS-i nuk ka bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik ashtu siç e përcakton Kodi i Matjes.

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore është konstatuar se në rastin konkret konsumatori ka obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar, por që jo të ngarkohet pa bazë pa u konstatuar saktë që njehsori elektrik nuk ka bërë matje të saktë.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit F.H. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së